



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr prot. 06-16378 2025

Datë: 04.06 2025

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 11, 12.2 shkronja c), dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja a) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, dispozitat e nenit 2,3, 8 dhe 13 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr.03/L-049 publikuar në Gazetën Zyrtare nr.27/2008, dispozitat e nenit 10 pika 1 të Statutit të Komunës së Klinës nr.01-110-1232/2010 i miratuar më dt. 31.03.2010, dispozitat e Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, me rekomandimet e KPF-së si dhe sipas kërkesës për rishqyrtim nga MMPHI shkresa me Nr. VL 51-25, Kuvendi i Komunës në seancën e V-të të rregullt të mbajtur më datë: 30.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale në Komunën e Klinës me plotësim-ndryshim sipas shkresës së MMPHI-së me Nr. VL 51-25.
2. Rregullorja ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale në Komunën e Klinës, lartësinë e taksave komunale dhe përcaktimin e kategorive të lira nga kjo taksë.
3. Pjesë e këtij Vendimi është rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale në Komunën e Klinës.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Rregullorja për Tarifatat, ngarkesat dhe gjërat komunale nr. 01-434-16778/19, e datës 25.04.2019 si dhe vendimi për plotësim-ndryshim të kësaj Rregulloreje, nr. 06-7778/2021 i datës 04.03.2021.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet kryetari i komunës në bashkëpunim me drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
6. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.


Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi
